



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Leje Ndërtimore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/02-23386

Dt. 25.06.2024

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:

Emri:	Shpetim (Shaqir) Zeka nga Gjakova.		
Adresa:	Rruga "Petro Nini Luarasi" nga Gjakova.		
Telefoni:	049 621 862	Emaili:	

Emri i Projektit:	Objekt i kategorisë së parë me destinim, objekt i banimit individual me etazhitet B+P+2+KSH.		
Emri i Projektuesit:	N.P. "ALBA – CONARK" A.ZH. Gjakovë.		
Adresa:	Rruga "Isa Boletini" nr.2		
Telefoni:	044 122 818	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:

Adresa: Rruga "Petro Nini Luarasi".		
Zona(t) Kadastrale: Gjakovë-J-Qytet	Nr. i parcelave kadastrale: 5049-18	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Ndërtim i ri ☒ Rindërtim ☐ Riparim ☐

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria I ☒ Kategoria II ☐

Përdorimi i propozuar:

A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒

Përshkrimi: Lejohet ndërtimi i objektit kategorisë së parë me destinim, objekt i banimit individual, me etazhitet B+P+2+KSH.

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Shpetim (Shaqir) Zeka nga Gjakova** i lejohet ndërtimi i objektit kategorisë së parë me destinim, objekt i banimit individual, me etazhitet B+P+2+KSH, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim **S=745.39 m²**.

Bodrumi:	(Sip.Bruto):	S=290.26 m²
Përdhese:	(Sip.Bruto):	S=116.92 m²
Kati i parë:	(Sip.Bruto):	S=137.75 m²
Kati i dytë:	(Sip.Bruto):	S=137.75 m²
Kulmi i shfrytëzueshëm:	(Sip.Bruto):	S=65.71 m²

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përkthim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi: **Shpetim (Shaqir) Zeka nga Gjakova** me banim në rrugën “Petro Nini Luarasi”, përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-23386 të datës 06.12.2023 të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin kategorisë së parë me destinim, objekt i banimit individual, me etazhitet B+P+2+KSH në ngastrën kadastrale me numër 5049-18, ZK: Gjakovë-J-Qytet në pronësi të Shpetim (Shaqir) Zeka nga Gjakova.

DUMM, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimit të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt. 20.09.2023.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën e pronës e paluajtshme në pronësi të Shpetim (Shaqir) Zeka nga Gjakova lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Raportin sqarues nga zyrtari përgjegjës për lëndën - urbanisti.
- Pëlqimi – Certifikata e inspektoratit sanitar me nr. 14-530/01-3401 të datës 19.03.2024.
- Përgjigjen në kërkesë me nr. 08-320/01-2143, dt. 29.02.2024, lëshuar nga DBPZHR.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, nr. 4/62 të datës 03.10.2023.
- Pëlqimin nga K.R.U. ”Gjakova” Sh.A. Gjakovë, nr.2809 të datës 26.09.2023.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, nr. 372 të datës 22.09.2023.
- Pëlqimin për ndërtim me nr. 306, dt. 05.07.2023, nga IPKO.
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në NLB Banka, filiali në Gjakovë me datë 04.04.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga N.P. “ALBA – CONARK”A.ZH. Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 2113.59 Euro.

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 20.09.2023, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Arkivit.

Hartoi aktin


Zenel Shabani Z.L.Ligjor

Zyrtari përgjegjës për lëndën

Mirlinada Mullahasani I.D.A.

Drejtori


Arben Bakalli

